




KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren  
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Bordi i Drejtorëve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren, në cilësinë e Panelit Intervistues dhe Vlerësues mbi bazën e vlerësimeve individuale të panelistëve, si dhe vlerësimin dhe poentimin mesatar të dalë nga vlerësimet individuale, e në pajtim me dispozitat ligjore të Nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, pas zhvillimit të procedurave të Konkursit Publik me Nr. 3182, datë 25.08.2023, merr këtë:

### VENDIM

Mbi zgjedhjen Sekretar/e në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren.

Për pozitën Sekretar/e në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren, sipas Konkursit me Nr. 3182, datë 25.08.2023, doli se Z. Vetim Shala, prej 600 pikëve maksimale është vlerësuar me 533 pikë apo me mesatare 88.83, dhe bazuar në këto nga panelistët shpallet si kandidat më i suksesshëm.

### Arsyetim

Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren me kompetencë të plotë në bazë të Nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 dhe kërkesave të përgjithshme të Konkursit Publik me Nr. 3182, i publikuar me datë 25.08.2023, i ka zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme ligjore me ç'rast u intervistuan 3 (tre) kandidat, ku më i suksesshëm u tregua Z. Vetim Shala i cili nga 600 pikët maksimale është vlerësuar me 533 pikë, dhe me mesatare 88,83!

Prandaj Bordi i Drejtorëve pas përmbjlljes me sukses të procesit të rekrutimit për Sekretar/e në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kandidatet pakënaqur me këtë Vendim mundë të ushtrojnë Ankesë në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. në Prizren në afat prej **8 (tetë)** ditësh kalendarike nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Prizren,

19.10.2023

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

  
Feim Fetoshi

